

# Rrota e Jetës

*Fleta e Mësuesit*

## Vlerat

Reflektimi, Respekti, Mirëkuptimi, Vet-analiza.

## Qëllimet

**Pedagogjike:** Reflektimi rreth fushave të ndryshme të jetës dhe rëndësisë së ekuilibrit midis tyre.

**Praktike:** Përgatitja e një rrote të jetës personale, duke reflektuar rreth niveleve të kënaqësisë për secilën nga këto fusha të jetës.

## Pjesëmarrësit

Minimumi: 2 pjesëmarrës  
Maksimumi: 30 pjesëmarrës

## Kohëzgjatja

60 minuta


## Materialet

Letër dhe stilolaps për çdo nxënës.

## Përmbledhje

Mësuesi/ja i jep secilit nxënës një fletë të bardhë dhe u kërkon atyre të vizatojnë një rreth të madh të ndarë në 8 pjesë trekëndësh (si prerja e një pice). Çdo pjesë duhet të përfaqësojë një fushë të ndryshme të jetës, për shembull, paratë, shkollën, ambjentin, zhvillimin personal, miqtë dhe familjen, njerëz të tjerë të rëndësishëm, shëndetin, argëtimin, krijimtarinë dhe të tjera. Më pas, secilës fushë të jetës duhet t'i caktohet një nivel i caktuar kënaqësie, duke konsideruar qendrën e rrethit "0" (pakënaqësia totale) dhe vijën e harkut të tij "10" (kënaqësia totale). Pasi të vizatojnë një hark të ri për secilën fushë të jetës, nxënësit duhet të ngjyrosin pjesën nga qendra deri te harku i secilës fushë të jetës duke paraqitur në këtë mënyrë nivelin e kënaqësisë për secilën.


Mësuesi mund të ilustron në tabelë shembullin e mëposhtëm për të orientuar nxënësit në vizatimin e Rrotes së tyre të jetës.



# Rrota e Jetës

*Fleta e Mësuesit (vazhdim)*

**Përmbledhje  
(vazhdim)**



Mësuesi duhet t'u bëjë të qartë nxënësve se qëllimi i aktivitetit nuk është që të fitojnë maksimumin "10" pikë në të gjitha fushat, por që të reflektojnë rreth fushave të jetës që kanë nevojë më shumë për vëmendje.

Nxënësit e ndajnë Rrotën e tyre të Jetës, në grupe dyshe, dhe reflektojnë mbi pyetjet e mëposhtme, të cilat mësuesi/ja mund t'i shkruajë në tabelë.

Në cilat fusha ke nevojë që të punosh më shumë?

Pse janë këto fusha të rëndësishme për ty?

Sa shumë mund të arrish të përmirësohesh?

Çfarë duhet të bësh që të arrish të përmirësohesh?

Cili është hapi i parë drejt përmirësimit?

Si u ndjeve kur pe Rrotën tënde të Jetës?

Cilat janë fushat me nivel më të lartë dhe më të ulët të kënaqësisë?

Cilët faktorë përcaktojnë nivelin tënd të kënaqësisë?

Mund të bësh diçka për të përmirësuar fushat e jetës me nivel më të ulët të kënaqësisë?

Sa i rëndësishëm është ekuilibri midis fushave të ndryshme të jetës tënde? Çfarë mund të bësh për ta përmirësuar atë?

**Diskutim**

